



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRES

**SHPALLJE KONKURIMI I HAPUR
PËR
VENDE VAKANTE PRANË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit 111/2018 "Për Kadastrën", neni 11, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, shpall konkurimin për pozicionet vakante, si më poshtë:

I. Në Drejtorinë e ASHK, Gjirokastrë:

Specialist (3), në profilin: *Jurist* Kategorja: IV-a. Niveli minimal i diplomës "Bachelor".

Specialist (1), në profilin: *Gjeodezi; Inxhinieri Ndërtimi; Arkitekturë; Gjeologji; Gjeoinformatikë, juridik*. Kategorja: IV-a. Niveli minimal i diplomës "Bachelor".

II. Në Drejtorinë e ASHK, Tepelenë:

Specialist (1), në profilin: *Jurist*, Kategorja: IV-a. Niveli minimal i diplomës "Bachelor".

Specialist (1), në profilin: *Gjeodezi; Inxhinieri Ndërtimi; Arkitekturë; Gjeologji; Gjeoinformatikë*. Kategorja: IV-a. Niveli minimal i diplomës "Bachelor".

❖ **Kushtet që duhet të plotësojë kandidatët:**

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme, të përcaktuara në legjisllacionin e shërbimit civil sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme, si vijon:

- Kandidatët duhet të zotërojnë diplomë të Arsimit të Lartë, nivelit minimal "Bachelor", në profilin e kërkuar dhe, të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në profesion.
- Të mos kenë masë largim nga puna në fuqi.
- Të kenë njohuri të gjuhës angleze ose të një gjuhe tjetër të BE-së.
- Preferohet të kenë trajnime apo kualifikime në fushën përkatëse.
- Preferohet të kenë eksperiencë pune në fushën e pronësisë

❖ **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit.**

Kandidatët duhet të dorëzojnë fotokopje të dokumentacionit, si më poshtë:

- a) Kërkesë/letër interesi, për pozicionin për të cilin është i interesuar kandidati.
- b) Jetëshkrim (CV)
- c) Fotokopje të diplomës Bachelor ose/dhe Master (nëse ka) dhe listës së notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet edhe njehsimi nga Ministria e Arsimit;
- d) Fotokopje të librezës së punës (*Të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë*);
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Çertifikatë familjare
- g) Vërtetim të gjendjes shëndetësore,
- h) Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces hetimi),
- i) Vërtetim nga gjykata (që nuk është në proces gjyqësor penal).
- j) Vërtetim të gjendjes gjyqësore/ Formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore
- k) Referencë (Rekomandim) nga punëdhënës të mëparshëm
- l) Adresën e saktë të vendbanimit, email dhe kontakt telefonik.
- m) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

- **Dokumentacioni i përcaktuar në pikat “g”, “h”, “i” dhe “j” duhet të jetë lëshuar jo më parë se 3 muaj nga momenti i aplikimit.**

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet, nëpërmjet postës zyrtare, apo dorazi në Zyrën e Protokollit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK.

Çdo aplikant i cili, brenda afatit të përcaktuar, nuk dërgon të gjithë dokumentacionin e kërkuar, apo paraqet dokumentacion jashtë afatit të vlefshmërisë humbet automatikisht, të drejtën e vijimit të fazave të konkurimit.

Dorëzimi i dokumenteve duhet të bëhet brenda datës: 24.02.2023.

❖ **Shpallja e rezultateve për fazën e verifikimit paraprak të kandidaturave.**

Në datën **28.02.2023**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore do të njoftojë kandidatët individualisht, (nëpërmjet adresës së e-mail), si dhe nëpërmjet publikimit në ambientet e institucionit, të informacioneve në lidhje me listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret, fazat e testimit, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

❖ **Fushat e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim :**

I. Kandidatët do të testohen me shkrim rreth njohurive mbi legjislacionin e mëposhtëm: Kushtetutën e RSH; Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; Ligji 20/20 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH”; aktet nënligjore në zbatim të Ligjit 111/2018 dhe ligjit 20/20; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Ligji Nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; Ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i RSH”, i ndryshuar (Dispozitat mbi pronësinë); Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 162 /2020 “Për prokurimin publik”, Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”; Ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit"; Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar; Ligji nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës më administratën publike”, i ndryshuar; Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me fushën përkatëse.

Vlerësimi i kandidatëve

Kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do ti nënshtrohen procedurave të mëtejshme të vlerësimit, nga një komision i posaçëm i ngritur për këtë qëllim, në lidhje me:

a - Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;

b - Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 30 pikë

Gjatë intervistës do të vlerësohen në lidhje me: Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me pozicionet për të cilat aplikojnë; Eksperiencën e tyre të mëparshme si dhe motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën).

c - Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 30 pikë.

Kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistën e strukturuar me gojë kandidatët të cilët kanë grumbulluar në vlerësimin me shkrim të paktën gjysmën e pikëve (20 pikë)

Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK, Rr. “Dora D’Istria”, Nr.2, Tiranë. Kandidatët që kualifikohen të marrin pjesë në intervistën me gojë do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve (nëpërmjet adresës së e-mail) mbi datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

❖ **Shpallja e rezultateve të konkurimit**

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail të paraqitur ne dokumentacionin e aplikimit).

Kandidati që merr më pak se 50 pikë në total nuk konsiderohet i suksesshëm.